



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 890, Datë 10.06.2022

“Mbi miratimin e Udhëzimit mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Denar BIBA	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Znj. Rezana KONOMI	Anetar

Në mbledhjen e tij të datës 10.06.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, germa d) dhe neni 26.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës ,
- Draft udhëzimit

VËREN SE :

1. Qëllimi i Udhëzimit lidhur me marrëveshjet me rëndësi të vogël” (Rregullorja “de Minimis”) është ofrimi i sigurisë për ato lloj marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve, për të cilat Autoriteti i Konkurrencës (AK) vlerëson se nuk sjellin efekte mbi konkurrencën në treg. Sqaron kufizimet “sipas objektit” në marrëveshjet midis jo-kokurentëve, të cilat mund të dallohen në rastet kur ato lidhen me ndarjen e tregut sipas territorit dhe/ose grupit të klientëve ose me kufizimet në aftësinë e blerësit për të përcaktuar çmimin e rishitjes.
2. Përcaktimin e tre kufizimeve klasike "sipas objektit" në marrëveshjet midis konkurrentëve janë fiksimi i çmimeve, kufizimi i prodhimit dhe ndarja e tregut

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzimit “Mbi kufizimet e konkurrencës” sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.